

## **Funksionet dhe detyrat e gjykatës.**

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë pjesa e nëntë titulluar “Gjykatat” neni 135:

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.....

Gjykata e Apelit Shkodër shqyrton çështjet gjyqësore të ardhura nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore: Shkodër, Pukë, Lezhë, Kukës, Tropojë, në bazë të ankimit të njërës apo disa palëve.

Dosja e çështjes gjyqësore në momentin e ardhjes në Gjykatën e Apelit Shkodër regjistrohet nga nëpunësi që ka për detyrë regjistrimin e çështjeve në sistemin përkatës elektronik (ICMIS) dhe me plotësimin e të dhënave (informacioni mbi çështjen, baza ligjore, palët ndërgjyqëse, vendimet e mëparshme të dhëna nga gjykatat, etj.) sistemi i vendos çështjes automatikisht një numër. Në zbatim të urdhërave të Kryetarit të Gjykatës mbi mënyrën e shortimit elektronik të dosjeve gjyqësore në gjykata, dosja hidhet për short, duke i kaluar gjyqtarit/relator. Ky short është elektronik dhe nuk mund të bëhen modifikime apo ndërhyrje në të.

Kur çështja kalon për gjykim, njoftimi për datën dhe orën e gjykimit bëhet nga Gjykata e Apelit duke e afishuar këtë njoftim tek stendat e lajmërimeve që janë në hyrje të Gjykatës së Apelit. Kjo shpallje vendoset edhe në stendat e lajmërimeve të Gjykatave përkatëse të rrethit (konkretish para gjykates se rrethit e cila ka dhënë vendimin). Për raste të parashikuara në ligjet procedurale për çështje të caktuara, gjyqtarit mund të vlerësojë edhe thirrjen e palëve në gjykim nga sekretaria gjyqësore.

Në Gjykatën e Apelit Shkodër çështjet gjykohen nga një trup gjykues, të përbërë prej 3 gjyqtarësh, me përjashtim të raste për të cilat ligji parashikon edhe gjykimin nga 1 gjyqtar i vetëm.

Pas dhënies së vendimit nga ana e gjykatës së apelit, nëse palët nuk janë dakort, mund të bëjnë rekurs në Gjykatën e Lartë Tiranë, brenda një afati të percaktuar ligjor. Afati i rekursit për çështjet civile është 30 ditë dhe afati i rekursit për çështjet penale është 45 ditë.

Ky rekurs duhet të depozitohet, pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, e cila pas ezaurimit të veprimeve administrative me dosjen gjyqësore përcjell nëpërmjet shërbimit postar dosjet gjyqësore pranë Gjykatës së Lartë ose sipas rastit nëse nuk është ushtruar rekurs në gjykatat e rretheve përkatëse.

Në ushtrimin e pushtetit gjyqësor gjykata ndihmohet nga administrata gjyqësore, e cila përfshin shërbimet e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe shërbime të tjera mbështetëse.

Gjatë veprimtarisë gjyqësore, gjyqtarët e gjykatës asistohen nga administrata gjyqësore e cila përmbush veprimtarinë e saj sipas ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Administrata gjyqësore kryen detyrat e saj në përputhje me ligjet procedurale në fuqi dhe aktet ligjore e nënligjore të nxjerra për këtë qëllim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë.